



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	23.06.2025	04.07.2025	2025/0511
Eksperti Teknik	Data e autorizimit të ekspertit teknik		
Sezair Ruhani	23.06.2025		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 20.06.2025, OE “PRO MEDICAL SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0511, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “SCHEHAM SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “” Furnizim me Paisje Mjeksore ”” me nr. të prokurimit: "651-24-11502-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates: 69,900.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “PRO MEDICAL SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Paisje Mjeksore ” me numër të prokurimit: “651-24-11502-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN

Dispozitat e shkelura te LPP-se:

Neni 1 - Qellimi

Neni 7 - Barazia ne trajtim/ jo diskriminimi

Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 11 - Informatat sekrete afariste

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<p>Kapaciteti teknik dhe profesional</p> <p>Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të ngjashëm gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontrate) - së paku një furnizim.</p> <p>Kërkesa 2. OE duhet të ofroj Katalogu për paisje te ofruara medicinale me të dhëna teknike që të bëhet krahasimi në mes të paisjeve të ofruara dhe të kërkuara (të jenë të</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Dëshmia 1. - Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7 të DT. - ku listës duhet ti bashkëngjiten këto dëshmi:</p> <p>i) Kur furnizimi është kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohet certifica – raporti i pranimit te furnizimit ose referenca të lëshuar nga autoriteti i tillë.</p> <p>ii) Kur furnizimi është kryer për një blerës privat, kopja e çdo dokumenti qe ka te shënuar llojin e furnizimeve te kryera dhe është i nënshkruar nga blerësi dhe ofruesi furnizimeve .</p> <p>Dëshmia 2. Katalogu për paisje te ofruara medicinale- Specifikacioni të përputhet me katallog, në katallog të nënvizohen specifikat e aparatit të ofruar</p>
		<p>nënvizuara ato specifike të cilat afrohen)-</p> <p>Kërkesa 3. OE duhet te jet i autorizuar nga prodhuesi ose dileri per shitjen dhe servisimin e paisjeve mjeksore.</p> <p>Kerkesa 4. OE duhet te ofroj Certifikaten e prodhuesit apo deklaraten per mos Aplikimi te CE per ndonje product.</p>	<p>Dëshmia 3. Autorizim nga prodhuesi për shitje dhe servisim për paisjet e ofruar = (original).</p> <p>Deshmit 4. – Certifikaten kopje, apo Deklaraten te nenshkruar dhe vulosur nga OE .</p>

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Version i korigjuar

“ Furnizim me Paisje Mjeksore ”

1. Analizator për analize kimike (stripa) dhe sediment të urines 2 cope

Detektimi i klasave të elementeve në urine :

Qelizat e kuqe të gjakut (RBC); Qelizat e bardha të gjakut (WBC); WBC Clumps (WBCc); casts qelqor (hya); casts patologjike (PAT); Qelizat epiteliiale squamous (EPI); Non-squamous qelizave epiteliiale, (NEC); Bakteret (BAC); Maja (po); Kristal (CRY); Kalciumi-oxalate monohidrat (CaO), Kalcium-oxalate dihydrate (coaxed), acid urik (URI), phosphate Triple (TRI); Mukozë (MUC); Sperm (SPRM); Klasat e tjera të subklasifikimit manual të jenë gjithashtu në dispozicion.

Teknologjia e punës:

Perdorim kivete me bazë mikroskopi të automatizuar dhe përpunimin të imazhit.

Operimi me kosto shumë efektive, Pa reagjent të lëngshëm dhe pa kalibrator.

Centrifugim të urines mbrenda njësis punuese të paisjes dhe mbrenda kohës së leximit në 1 min .

Vlerësimi imazheve automatike dhe të besueshme nga AIEM, e cila është e cilësisë së lartë të përpunimit të imazhit softwerik

Xhiroja: Deri në 60 teste / orë.

Cikli i përgjithshëm matjes të jetë më pak se 1 minutë.

Krijimi raport të plotë për sediment të urinës .

Futja e të dhënave nëpërmjet lexuesit barcode opcional dhe tastierës të jashtme.

Operim të lehtë përmes workstation PC, softuer me përdorim të shpejtë.

Kapaciteti Memory:

Ruajtja e rezultatëve deri në 5000 (përfshirë të gjitha imazhet)

Display: Monitor.

Lexues barcode: opcional barcod të jashtme

Printer: opcional të jashtme.

Moduli i analizës kimike:

-Pajisja të lidhet me njesine per Sediment urine ne menyre qe te krijohet nje Raport I rezultatit

-Kapaciteti minimum 50 teste ne ore.

-Parametrat: leukocite, blood, ph, Nitrite, Glukoza, Protein, Ac Ascorbit, Ketone, Bilirubin, urobilinogjen, pesha specifike.

-Metoda e diktimit: dozimi i mostrës nga njësia e pipetimit.

-Metoda e punës: Reflektance fotometri dhe fotometria e transmetimit.

-Printer thermal, lexues barkodesh, deri 10 mij mostra të ruajtura në memorje.

-Transfer automatik të rezultateve -LIS

2.Defibrilator manual 4 cope

Ekran me ngjyra TFT ose LCD me rezolucion të lartë 6 - 8 inç

Zgjedhja e energjisë: 2,5,7,10,20,30,50,70,100,150,200,300,360 xhaule

Alarmi zanor i pajisjes së defibrilatorit

Koha e karikimit: Më pak se 7 sekonda me një bateri të re, plotësisht të ngarkuar

Ekrani i energjisë: ekran i monitorit tregon energjinë e zgjedhur dhe të dhënë

Kërkesat e karikimit: Kërkesat zanore dhe vizuale

Gama e matjes së rezistencës së elektrodës: 0-250 ohms

Modaliteti manual

Printer i integruar

Lopat e jashtme standarde të ripërdorshme për të rriturit dhe fëmijët (të integruara me vozita pediatrike)

Funksioni AED: Analizë automatike dhe karikimx3 me zgjedhje automatike të nivelit të energjisë të programueshme

Forma e valës së daljes: Teknologjia bifazike

Parametri standard është EKG: I II III AVR AVL AVF V

Opsione:

SpO2, modul NIBP, modul EtCO2, stimulues kardiak, karrocë, këllëf mbajtëse

2.Defibrilator

Kablo patienti me 3 tela me 5 bërthama

Madhësia: 6 - 8 inç

Lloji: Ngjyra TFT ose LCD

Shpejtësia e kalimit: 12.5mm/s25mm/s50mm/s

Zgjedhja e drejtuesve: I II III AVR AVL AVF V.

Përgjigja e frekuencës: (zgjidhet nga përdoruesi).

Modaliteti i funksionimit 0,7 deri në 20 Hz

Modaliteti i monitorimit 0,3 deri në 40 Hz

Modaliteti i analizës 0,05 deri në 150 Hz

Modaliteti AED 0,5 deri në 30 Hz

Refuzimi i zakonshëm i modalitetit: > =60dB

Monitorues i rrahjeve të zemrës: 20 deri në 300 BPM.

Alarmet e rrahjeve të zemrës: i përzgjedhur nga përdoruesi.

Madhësia: 0,125 0,25 0,5 1 2 4 cm/mv dhe rangut automatik.

3.Defibrilator AED 7 cope

- Defibrilimi

Mënyra gjysmë automatike

Vala: bifazike, puls i kontrolluar nga rryma

Energjia: 50-360J

Koha e karikimit: < 12 sek @ 360 J

Mënyrat e funksionimit: asinkron

Mënyra pediatrike

- EKG

Drejtimes: II

Gama e rezistencës së pacientit: 23-200 Ohm

Rrahjet e zemrës: 30-300 për minutë

- Zbulimi VF-VT

Zbulimi VF/VT

Koha e analizës 7-12 sek

Pragu i asistolës: <0.2mV

Artefakt - Zbulimi i stimuluesit kardiak

- Elektroda

Elektroda jo të polarizuara, gjatësia e kabllit 2 m deri 3 m

- Monitor LCD

95x72 mm (diagonale 4,7"/120 mm)

Shfaqja e statusit të baterisë së ruajtjes

Shpejtësia 25 mm/s

Frekuenca e zemrës, numri i defibrilimit, numri i VF/VT, koha totale e ringjalljes

- Rezervimi i të dhënave

Regjistrimi i zërit

- Furnizimi me energji elektrike

AkuPak Lite me bateri të rikarikueshme 100-240 V, 50/60 Hz - 150 shkarkime në 200J

- 5 orë monitorim

- Shfaqja e statusit

Vizualizimi i gjendjes së defibrilatorit dhe baterisë

4. Autokllav 4 cope

Specifikat per Autokllav

Kapaciteti 18 deri 25 litra

Temperatura 121 deri 134 celcius

Pesha 40 deri 60 kg

Tregues digjital I temperatures

Lloji: horizontal

5. Monitor per monitorim te pacientit 4 cope

- EKG

Kanal me 5 priza, dy kanale, 3 kanale, me një kanal

Shpejtësia e skanimit: 12,5 mm/s, 50 mm/s

Monitorimi i segmentit ST

Gama e matjes dhe alarmit: -2,0 mV ±2,0 mV

- RESP

Metoda: R-F (RA-LL) impedanca

Gama e matjes dhe alarmit: 0-150 rpm

Alarmi i apnesë: 10-40 sek

- NIBP - Metoda oshilometrike

Modaliteti: manual / AUTO / i vazhdueshëm

Intervali i matjes në modalitetin AUTO:
1/2/3/4/5/10/15/30/60/90/120/240/480/960 min

Periudha e matjes në modalitetin CONT: 5 min

Alarmi i matjes: 10-270 mmHg

- SpO2

Gama e matjes dhe alarmit: 0-100%

Saktësia e matjes: 70-100% ±2%

- PR

Gama e matjes dhe alarmit: 30-250 bpm

- TEMP

Kanali: me dy kanale

Gama e matjes dhe alarmit: 0-50 °C

Furnizimi me energji elektrike: 110-240 V - 50/60 Hz

Klasifikimi i sigurisë: Klasa I tip CF

Pjesë e aplikuar rezistente ndaj defibrilimit

6. Shtrate levizes per bartje te pacienteve 3 cope

- Kornizë metalike.
- Platformë dysheku. (HPL e petëzuar kompakte)
- Rregullimi i lartësisë. (hidraulike)
- Trendelenburg dhe trendelenburg i kundërt (hidraulik).
- Rregullimi i mbështetëses. (pistoni me gaz)
- Rregullimi i pushimit të kofshëve. (pistoni me gaz)
- Mbështetëse e këmbëve. (manuel) • Binarët anësor. (metal)

xternal Dimensionet: 1965 x 780 mm

Platforma e dyshekut: 1850 x 600 mm

Trashësia e dyshekut: 80 mm

Rregullimi i lartësisë: 770 - 1060 mm

Mbështetësja max. këndi: 70°

Mbështetësja e këmbëve max. këndi: 30°

Trendelenburg / Rev.trendelenburg: + 18 ° / - 18 °

Lartësia e shinave anësore: 270 mm

Hapësira nën shtrat: 130 mm

Diametri i rrotave: 150 mm

Ngarkesa e sigurt e punës: 125 kg

7. Tavoline per terapi 8 cope

- Kornizë metalike.
- Tavolinë e sipërme prej çeliku inox.
- Barriera mbrojtëse në tavolinën e sipërme.
- Dorezë shtytëse metalike.
- Tabaka inox për preparatet e barnave
- Poli IV • Koshi i plehrave. (1 copë)
- Ndarja e skedarit dhe e sondës. (1 copë)
- Sirtar prej druri. (4 copë)
- Tas inox. (1 copë)
- Rriqë dy me thyerje.
- Kornizë elektrostatische e veshur me pluhur. (RAL 2004)

Dimensionet e jashtme: Standard

Lartësia: Standard

Tavolina e sipërme: Standard

Diametri i rrotave: Standard

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**PRO MEDICAL SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**” Furnizim me Paisje Mjeksore ”**” me numër të prokurimit: “**651-24-11502-1-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

8. Shtrat per Ranimim 4 cope

SPECIFIKIMET:

Materiali: Korniz çelik ABS & PP Plastike

Dimensioni: 2260mm(L)*1100mm(W)*535mm-720mm

Shtrati: 1940mm(L)*900mm(W)

Pesha NETO: 148 kg

Kapaciteti ngarkues: <250 Kg

Costor frena: 150mm universal (Mbyllja qendrore), Frena

Funksioni per RPK reanimim kardiopulmunar, në rast

Emergjence dërrasa e krevatit të pasmë mund te kthehet

Shpejt në sheshhtë me anë të levës së lëshimit të shpejë manual.

Për të gjitha paisjet OE duhet te ofrojn garancion 24 muaj.

Operatori Ekonomik duhet të deklarojë me shkrim dhe të vërtetojë me nënshkrim dhe vulë, se ka lexuar të gjitha specifikat për mallin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues dhe se zotohet t'i plotësojë të gjitha sipas përshkrimit në aneksin e specifikave për mallrat në fjalë.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit , komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i pergjegjshem.

OE i rekomanduar per kontrate eshte i pergjegjshem.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - PRO MEDICAL SH.P.K.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me njoftimin mbi Vendimin (B58) të AK-Komuna Gjilan, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 të LPP-se.

Pretendimi nr. 1

OE ankues, pretendon se, me rastin e publikimit te vendimit B58, kemi kerkuar qasje ne dy ofertat tjera pjesmarrese, ndersa AK, qasjen e plot na e lejon te oferta e OE te rekomanduar per kontrate, ndersa te oferta e OE Ari Med, nuk kemi pasur qasje te plote.

Eksperti shqyrtues, lidhur me kete pretendim, sqaron se autoriteti kontraktues, me te drejte nuk i ka ofruar qasje te plot ne oferten e OE Ari Med sepse i njejti e ka dorzuar kerkesen per sekret afarist.

Pretendimi nr. 2.

Sa i perket pretendimit te OE ankues, lidhur me deklaraten e specifikave teknike, eksperti shqyrtues, sqaron se OE Ari Med e ka dorezuar deklaraten e specifikave teknike te detyrueshme, ndersa OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka dorezuar ne oferte.

Pretendimi nr. 3.

OE ankues, pasi nuk ka pasur qasje te plote kerkon qe te behet verifikimi ne sistemin e e-Prokurimit nese Operatori Ekonomik Ari Med, e ka dorëzuar vazhdimin e validitetit të ofertës, dhe nëse ka pasur validitet të pandërprerë gjatë gjithë periudhës, duke pasur parasysh se tenderi në fjalë është iniciuar më datë 25.11.2024.

Eksperti shqyrtues, lidhur me kete pretendim sqaron se AK, OE-ve te interesuar ju ka derguar kerkesen per zgjatje te validitetit, si me posht:


Dërguar nga : KUVENDI KOMUNAL- GJILAN

Dokumenti shtojca

- Kërkesë Vazhdim i Validitetit Furnizim me pajisje mjekësore.pdf

24.02.2025 14:36

Hape:

 Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip



Dërguar nga : KUVENDI KOMUNAL- GJILAN

Dokumenti shtojca

Kërkesë Vazhdim i Validitetit Furnizim me pajisje mjekësore
28.04.2025.pdf

28.04.2025 14:33

Hape:

 Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip



OE Ari Med i eshte pergjigjur kerkeses per zgjatje te validitetit ne po te njejten dite:

Dërguar nga : Ari med L.L.C.

Dokumenti për dërgim te AK

Deklaratë per shtyrje te Validitetit 24.02.2025.pdf

24.02.2025 16:23

Dërguar nga : Ari med L.L.C.

Dokumenti për dërgim te AK

Deklaratë per shtyrje te Validitetit 28.04.2025.pdf

28.04.2025 14:53

Pretendimi nr. 4.

OE ankues, pretendon se OE i rekomanduar per kontrate, nuk e ploteson kerkesen e dosjes se tenderit lidhur me kontratat dhe referencat, saktesisht pretendon se, lista e projekteve dhe referencave të ofruara nga OE SCHEHAM SH.P.K. përfshin vetëm furnizime të barnave farmaceutike, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratës - furnizimet me pajisje mjekësore. Sipas OE ankues, OE SCHEHAM SH.P.K. nuk ka siguruar asnjë projekt apo reference që dëshmojnë përvojë në furnizime me pajisje mjekësore, siç kërkohet në Dosjen e Tenderit (kriter për projekte të natyrës së ngjashme).

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK, ne dosje te tenderit ka kerkuar:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të ngjashëm gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontrate) - së paku një furnizim.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne listen e kontratave te dorezuar ne oferte, sqaron se OE i rekomanduari per kontrate, ka ofruar liste te furnizimit me barna dhe nuk ka dorezuar deshmi te furnizimit me pajisje mjekesore sipas kerkeses se cituar me larte. Pretendimi i OE ankues eshte i bazuar.

Pretendimi nr. 5.

OE ankues, pretendon se i rekomanduari per kontrate nuk e ka plotesuar – Pozicioni 3: Defibrilator AED, dhe 4. Autoklav

Përgjigje nga eksperti teknik në Pretendimi - Mosplotësimi i specifikacionit teknik – Pozicioni 3: Defibrilator AED

Pretendimi eshte i bazuar, per shkak se pas shqyrtimit te katalogut te OE te rekomanduar nuk ka ofruar pajisje Defibrilator AED qe i ploteson specifikat teknike te kerkuara.

Defibrilatori i ofruar me emer Altai Dp1 sipas katalog ofron Shock Output ne rangun prej 50j-150j ndersa ne specifikmet teknike te kerkuara nga AK eshte 50j-360j.

Pozicioni 4. – Autoklave 4 cope

Pretendimi mbi pozicionin 4 eshte i bazuar, per arsye se OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka specifikuar cilin lloj te autoklaves e ka ofertu per pozicionin e kerkuar, duke ofruar dy

modele nga dy prodhues te ndryshem. Prandaj ne kete menyre AK nuk ka pasur mundesi te vleresoj drejte se cili nga modelet i ploteson specifikat e kerkuara teknike ne DT.

Pozicioni 8 Tavolina per terapi – 8 cope

Ne dokumentacionin e ofruar nuk kemi te dhena qe konfirmojne apo jo nese eshte ofruar tavolinat e kerkuara sipas specifikave ne Dosjen e Tenderit. Prandaj edhe kjo ankese konsiderohet e bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues-teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**PRO MEDICAL SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me Paisje Mjekësore**” me numër të prokurimit: “**651-24-11502-1-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **PRO MEDICAL SH.P.K.**



Florije Rexhepi

Sezair Ruhani